



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

A.nr. 569/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi - kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Kujtim Pasuli - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren, ndaj Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në ditën e votimit për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës të mbajtura më datë 09.shkurt.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.02.2025, merr këtë,

V E N D I M

HUDHET e palejuar ankesa A.nr.569/2025, e datës 11.02.2025, e parashtruar nga subjekti politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren, ndaj Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në ditën e votimit për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës të mbajtura më datë 09.shkurt.2025.

A r s y e t i m

PZAP-i ka pranuar ankesën Anr.569/2025, të datës 11.02.2025 nga subjekti politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren, në të cilën pretendon se për shkak dyshimeve në parregullsitë në procesin e numërimit të votave për Zgjedhjet Parlamentare të mbajtura më 9 shkurt 2025, konkretisht, besojmë se komisionerët e ngarkuar me numërimin e votave nuk arritën të regjistrojnë siç duhet të gjitha votat që përkisnin Nova Demokratska Stranka (NDS), gjë që na dëmtoi drejtpërdrejt. Parregullsitë janë vërejtur në tri vendvotime në Komunën e Lipjanit: Vendvotimi 1304 — Shkolla " Haradin Bajrami" ,Vendvotimi 1315 Shkolla Fehmi Agani ", dhe Vendvotimi Shkolla "Ismail "Luma " Sipas informacioneve që kemi marrë, ka një mospërputhje mes numrit të votave të regjistruara në procesverbal dhe asaj që vëzhguesit tanë kanë regjistruar gjatë numërimit. Dyshimi ynë bazohet në faktin se ka pasur regjistrim joadekuat të votave, gjë që mund të nënkuptojë se votat tona i janë atribuar gabimisht subjekteve të tjera ose nuk janë marrë fare parasysh. Mendojmë se kjo procedurë shkel nenin 103 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, i cili ka të bëjë me transparencën dhe saktësinë e numërimit të votave. Gjithashtu, ekziston dyshimi i arsyeshëm se janë shkelur dispozitat e nenit 106, që kanë të bëjnë me detyrimin e komisioneve për të regjistruar me saktësi rezultatet dhe të garantojnë një proces të drejtë e të ligjshëm zgjedhor. Për arsyet e mësipërme kërkojmë:

Rinumërim të votave nga qendrat e mësipërme të votimit në prani të përfaqësuesve tanë të autorizuar dhe Auditimin e të gjitha procesverbaleve dhe ekstrakteve nga qendrat e votimit për të përcaktuar nëse ka ndonjë mospërputhje në rezultate Marrja e masave të duhura ndaj personave përgjegjës në rast të lëshimeve apo parregullsive të qëllimshme në procesin e numërimit të votave. NDS beson në një proces zgjedhor demokratik dhe të drejtë dhe për këtë arsye ne insistojmë në zbatimin e hapave të nevojshëm ligjorë për garantimin e drejtësisë zgjedhore dhe ruajtjen e integritetit të procesit zgjedhor.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

Paneli vlerëson se pretendimi i palës ankuese edhe pse i referohen parregullsive në ditën e votimit, për shkak se përmes kësaj ankese atakohet rezultati i cili është ende si rezultat preliminar, e i cili rezultat mund të ndryshoj, ankesa në këtë fazë të procesit zgjedhor është e parakohshme, për shkak se pas publikimit të rezultatit përfundimtar i njëjti rezultat është i ankimeshëm nga subjektet politike edhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numrin e votave të tyre. Meqenëse në aspektin kohor-faza e procesit zgjedhor kur parashtrahet ankesa është e parakohshme ankesa duhet të hedhet poshtë si e palejueshme.

Në momentin e publikimit të rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105.1 të Ligji Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar.


Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se *“PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht”* dhe Nenit 13.3 të Rregullores Nr.01 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: *“PZAP-i, e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim”*, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendosja sikurse në dispozitiv të këtij vendimi për hedhjen e ankesës të palejueshme nuk e prejudikon rezultatin përfundimtar e po ashtu me të njëjtat pretendime ankimore pala mund ta atakoj rezultatin përfundimtar.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së dhe 13.3 Rregullores Nr.01 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
A nr. 569/2025 më datën 12.02.2025

Kryesues i Panelit
Ramush Bardiqi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.